



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 27.12.2018)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Mbi nisjen e procedurave për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 11:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 2. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Mbi nisjen e procedurave për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Së pari, ju falënderoj që u mbledhët edhe pse jemi në fundin e vitit.

Arsyeja për të cilën ju kam kërkuar mbledhje ditën e sotshme është se janë tre çështje të cilat i kemi në rendin e ditës dhe që sipas gjykimit tonë janë çështje që kërkojnë që nga ana e Këshillit të veprohet sa më shpejt.

E para, si çështje imediate është nisja e procedurave për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2018.

Sikurse jemi në dijeni, detyrimet e përcaktuara në nenin 32 të ligjit “Për statusin...” kanë parashikuar që për kandidatët magjistratë, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet të bëhet një procedurë lidhur me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së tyre përpara se ato të emërohen në detyrë. Për këtë arsye është menduar që të fillohet procedura e përcaktuar në ligj.

Pika e dytë e rendit të ditës është nisja e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krime të rënda në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit.

Edhe kjo çështje është një çështje e cila ligji ka vënë afate prekluzive. Ligji e ka parashikuar dy javë nga momenti që krijohet Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për këto gjyqtarë duhet të fillojë procedura për caktimin e përkohshëm të tyre, duke u shprehur fillimisht përmes formularit të vullnetit të tyre për të qenë pjesë apo jo e kësaj trupe gjyqësore.

Dhe çështja e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me deklarimin e mbarimit të statusit magjistrat për shkak të dorëheqjes, të gjyqtarit Metush Saraçi, i cili ushtron funksionin e tij në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Këto janë tre çështje për të cilat ne do diskutojmë dhe do marrim vendim sot.

Jeni dakord me rendin?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord!

Ndonjë pyetje? Ndonjë paqartësi lidhur me rendin dhe me...?

Nuk kemi!

Atëherë, të kalojmë në shqyrtimin e pikës së parë e cila lidhet me nisjen e procedurave për emërimin e magjistratëve të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës viti 2018?

Jeni dakord?

(Anëtarët janë dakord dhe përgjigjen njëzëri dakord.)

Ta kalojmë në votim?

Dakord?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord! Faleminderit!

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 27.12.2018)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 11:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
2. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
5. *Përfaqësues të EURALIUS-it.*
6. *Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

2. Mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të gjykatave për krimet e rënda në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimet të organizuar.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pika e dytë që ka të bëjë mbi nisjen e procedurës për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve të krimeve të rënda.

Jemi dakord me këtë pikë?

(Anëtarët janë dakord.)

Kemi diskutime?

Po!

Dritan Hallunaj: Nëse mundem. Këtu tek rendi i ditës është përcaktuar nisja e procedurës. Pyetja është më tepër: -cilat janë hapat që do ndërmarrim ne? Pra nga sot do vijohet me dërgimin e atij akti që ato do marrin përsipër? Apo cilat do të jenë hapat? Se ka një procedurë që nga dispozitat ligjore ka një përplasje po themi, në thonjëza, midis këtyre dispozitave. Pse? Ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, neni 162 thotë që gjyqtarët e krimeve të rënda, brenda dy javëve nga konstituimi i Këshillit duhet të nënshkruajnë një deklaratë. Ndërsa Kushtetuta e Republikës, në nenin 179, pra tek dispozitat kalimtare, pika 8, thuhet që gjykata e shkallës së parë dhe e krimeve të rënda

do të emërojnë, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e gjykatës së shkallës së parë brenda 2 muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Duke referuar pra tek ligji “Për statusin...”, nëse do bëjmë një analogji me krijimin e SPAK-ut dhe prokurorisë antikorrupsion, themi se kemi një farë... pra duhet të bëjmë kujdes me këto hapat, pasi nëse ne atyre do t’i japim dy javë kohë dhe pastaj ne do të shprehemi nëse ato do të quhen si gjykata apo merr emërtimin, ndryshon emërtimi nga gjykata e krimeve të rënda në emërtimin gjykata antikorrupsion, ato nuk kanë prokurori të tillë apo nuk kanë përfaqësues të akuzës. Pra këtë doja të dija, pra pas dy javësh do të jetë emërtimi gjykata antikorrupsion apo do vijojmë me gjykatën e krimeve të rënda. Kjo është pjesa që duhet të diskutojmë.

Brunilda Kadi: Mundem?

Atëherë, ajo që propozohet tek kjo pikë e rendit të ditës është për të filluar procedura, pra është fillimi. Dhe të respektojmë të gjitha dispozitat ligjore, të gjitha hapat që po diskuton edhe kolegu dhe kam përshtypjen, për këtë pjesë neve duhet të jemi në komunikim edhe formal edhe informal me Këshillin tjetër për pjesën e SPAK-ut, që ato, logjikisht dhe ligjërisht duhet të krijohen në të njëjtën kohë, funksionin. Se ajo që ngre kolegu si diskutim, patjetër që është shumë e rëndësishme, që ato duhet të funksionojnë në një kohë sepse do jetë edhe problemi i kalimit/të transferimit të çështjeve konkrete që do kenë nëpër duar gjyqtarët e krimeve të rënda që janë sot. Kështu që, kam përshtypjen që ne thjesht sot po nisim procedurën dhe pastaj e gjithë procedura do t’i përfshijë të gjitha diskutimet. Nuk e di tani. Ky është mendimi im.

Brikena Ukperaj: Duke u bashkuar mendimit të dy kolegëve, e rëndësishme është që edhe për shkak të hierarkisë së akteve, ne do respektojmë parimin kushtetues që, brenda 2 muajve nga momenti i krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të bëhet kalimi nga Gjykata e Krimeve të Rënda tek gjykata e posaçme për gjykimin e veprave të tilla. Kështu që, sot fillojmë procedurën, me qëllim që gjyqtarët të plotësojnë formularët, edhe familjarët e tyre, sepse është kusht paraprak për caktimin e përkohshëm. Kështu që, duke iu dhënë atyre edhe kohën e mjaftueshme.

Pastaj, jam dakord me pjesën që edhe gjykata edhe prokuroria duhet të ngrihen në të njëjtën kohë sepse do kenë probleme të kompetencave dhe të veprave që do gjykojnë.

Për momentin, mendoj që është e rëndësishme që të fillojë procedura me plotësimin e formularëve.

Naureda Llagami: Diskutim tjetër?

Ilir Toska: E vetmja gjë që do desha ta theksoja është që ne duhet të fillojmë procedurat që të krijojmë institucionin/gjykatën. Kështu që nuk kuptoj këtë pjesën që është dyjavëshi apo dymuajshi. Ato kanë të bëjnë pikërisht me çështjen e krijimit brenda dy javëve apo çështjen e krijimit brenda dy muajve. Ne duhet të fillojmë menjëherë ta krijojmë këtë dhe që të krijojmë këtë institucion, duhet të fillojmë të bëjmë procedurat që të arrijmë deri tek krijimi. ...Që të mos kapërcejmë afatin, por të bëjmë të gjitha procedurat e nevojshme, që ta krijojmë.

Naureda Llagami: Atëherë, ajo që u tha edhe nga kolegët, ky hapi i parë që Këshilli do ndërmarrë për të filluar konstituimin e gjykatës së re. Atë që legjislatori ka specifikuar në nenin 162 është që, për të filluar krijimin e një gjykate të re, duhet marrë pëlqimi paraprak dhe thelbi i kësaj vendimmarrjeje është inicimi i marrjes së pëlqimit paraprak. Në momentin që ne do të na administrohen të gjithë formularët me vlerësimin, do jetë një pjesë e diskutimit të një mbledhjeje tjetër në rendin e ditës, që do e përcaktojmë së bashku, për situatën që është krijuar. Më pas, sa persona kanë pranuar që të jenë pjesë, sa persona nuk kanë pranuar. Besoj që edhe këtë gjë, gjatë gjithë kësaj periudhe ne do jemi në kontakt edhe me KLP-në, për të koordinuar edhe vendimmarrjen e tyre për përzgjedhjen e prokurorëve të SPAK-ut. Shqetësimi që adresohet është shumë i drejtë sepse ne e dimë shumë mirë që në një situatë që krijohet një gjykatë, kemi problemin e lëndës që do gjykojë kjo gjykatë dhe mund të krijojë probleme tek gjykata tjetër. Kështu që do mundohemi që në vendimmarrjen e mëpasshme të jemi të kujdesshëm pasi të koordinojmë edhe me Këshillin e Lartë Prokurorial.

Ta kalojmë në votim?

Jemi dakord me pikën 2?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2018

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 27.12.2018)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Mbi deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Metush Saraçi.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 11:17.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
2. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
3. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
4. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
5. *Përfaqësues të EURALIUS-it.*
6. *Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

3. Mbi deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak dorëheqjeje, të gjyqtarit Metush Saraçi.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pika 3.

Më datë 5 nëntor të vitit 2018, pranë KLD-së, ish KLD-së, është depozituar kërkesa për dorëheqje të gjyqtarit Metush Saraçi. Na rezultoi që gjatë kësaj periudhe, kjo kërkesë nuk është marrë në shqyrtim nga ish KLD-ja, për këtë arsye u përfshi në rendin e ditës së sotshëm.

E kemi të administruar me shkrim. E kemi në dosje në fakt.

Kështu që, jemi dakord që ta kalojmë për miratim deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, për zotin Metush Saraçi?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord.

Brikena Ukperaj: Mund të diskutojmë momentin e shtrirjes së dorëheqjes? Se momenti kohor është i rëndësishëm për t'u përcaktuar.

Medi Bici: Kur fillon, e ka të përcaktuar ligji.

Naureda Llagami: Efektet do fillojnë nga data 31 dhjetor.

Atëherë, mbledhjen për këtë vit, e konsideroj të mbyllur. Nuk besoj se do kemi mbledhje të tjera gjatë këtij viti. Ju ftoj që të reflektojmë lidhur me përbërjen e komisioneve, e cila do jetë çështje e mbledhjes së parë për 2018-ën. 2019-ën, më falni! Ju falenderoj! Gëzuar!

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor